

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"GIROMONDO" SH.P.K.**

(1) Sot, më date **28.08.2014**, ne themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**GIROMONDO**" SH.P.K.

(2) Themeluesit e shoqërisë janë:

- **ILIRJAN GËRVESHI** (d.l.10.08.1973 Lazarat,Gjirokaster).
- **GIUSTO GENTILI** (d.l.06.11.1947 Montegiorgio Itali),
Nr.Pashaportes YA6614954

Neni 1

Shoqëria krijohet dhe ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe sidomos Ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"; aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe me dispozitat e Statutit të Shoqërisë që i bashkangjitet këtij Akti Themelues.

Neni 2

Emertimi i shoqërisë është "**GIROMONDO**" sh.p.k.

Neni 3

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Siri Kodra" magazine të ish-Frigoriferi Tirane**. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër bëhet me miratimin e Asamblesë së ortakeve të shoqërisë.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

Sherbime me material të porositësit(Fason).Import-eksport,tregëtime shumice e pakice të mallrave të ndryshëm,transport mallrash brenda dhe jashtë vendit,ushqimore,kepuce,veshmbathje,tekstile,artikuj lekure,industrial,detergjente,kozmetike,hidrosanitare,material ndërtimi,hapje punishte për përpunim,prodhim,tregëtim lëndesh të para dhe mallrash,hapje agjensi imobilare:te shesë të jap me qera pasuri të tundshme dhe të patundshme,hapje servis makinash dhe shitblerje pjesë këmbimi për auto,goma automjetesh të ndryshme,hapje agjensi turistike. Shoqëria mund të zhvillojë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër të afert ose që lidhet me objektin e saj, e vetme ose me pjesëmarrje me ente, ndermarje apo shoqëri të tjera, duke kryer të gjitha operacionet financiare të nevojshme për arritjen e qëllimit të Shoqërisë.

Neni 5

Kohezgjatja e Shoqërisë është përcaktuar për një periudhë të pakufizuar kohe, por sidoqoftë jo më pak se **20 vjet**, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.



Neni 6

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000** Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Illirjan Gërveshi**: Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme që përben **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Giusto Gentili**: Zoterues i **1 (një)** kuote me vlerë të përgjithshme që përben **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Ortakët kanë te drejte te beje zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit sipas vendimit qe merr Asambleja e Ortakeve.

Neni 7

Ne marrëdhëniet me te tretet, shoqëria tregëtare **"GIROMONDO" sh.p.k.** perfaqësohet nga Admnistratori i Shoqërise.

Neni 8

Cdo gjë qe do te kryhet parashikohet ne statutin e shoqërise, kopje e te cilit do te depozitohet ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 9

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne Tirane, me 28.08.2014 ne kater ekzemplare origjinale ne gjuhen shqipe, duke patur te gjithë fuqi te barabarte ligjore.

ORTAKET

E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"GIROMONDO" SHPK

Illirjan Gërveshi **Illirjan Gërveshi**

Giusto Gentili **Giusto Gentili**